



Datë: 13.08.2025
Numër Protokolli: 6435/2025

A.nr.1174/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare e kolegjit, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë të kolegjit, më Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1174/2025, të datës 20.06.2025, të parashtruar nga ankuesi A.P, kundër organit të punësimit: Komuna e Klinës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 13.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1174/2025, e datës 20.06.2025, e parashtruar nga ankuesi A.P.

II. Mbetet në fuqi Propozimi 02 Nr.112-17425/2025, i datës 12.06.2025, i Komisionit të Ristrukturimit të Komunës së Klinës.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, A.P(tutje referuar vetëm ankuesi), më datë 19.06.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 20.06.2025, nën shenjen A.nr.1174/2025, kundër Propozimit 02 Nr.112-17425/2025, të datës 12.06.2025, të Komisionit të Ristrukturimit të Komunës së Klinës, lidhur me mos lëshimin e akt emërimit sipër klasës profesionale 2.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 10.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Klinës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 14.07.2025 ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4200/2025 të datës 20.06.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimin A.nr.506.2025 të KPMSHCK-së; Propozimin 02 Nr.112-17425/2025 të datës 12.06.2025, të Komisionit të Ristrukturimit të Komunës së Klinës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.07.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 14.07.2025; Diplomën e datës 20.06.1980; Vendimin e datës 11.01.2024 për caktimin e grupit punësi për hartimin e rregullores për organizmin e brendshëm; Propozimin e bërë nga Komuna e Klinës për DMZP; Akt Emërimit të datës 02.09.2024 dhe 01.08.2011 të ankuesit; Vendimin e datës 30.07.2024 për themelimin e komisionit të ristrukturimit; Rregulloren për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Komunën e Klinës; Formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin të vitit 2022, 2023 dhe 2024; Vendimin me numër protokolli 5181/2025 të datës 01.08.2025 për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës së ankuesit.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, **sepse:**

Nga provat e administruara rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Komunën e Klinës dhe se i njëjti ushtron pozitën Zyrtar për Gjendje Civile në Zyrën e Gjendjes Civile në fshatin Zllakuqan, rrjedhimisht, sipas Aktit të Emërimit 02Nr.112-29620/2024, të datës 02.09.2024, pozita e ankuesit është klasifikuar në kategorinë profesional 3, më klasë të pagës GJ45 dhe koeficient 3.92.

Me tej, sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesi më datë 14.03.2025, i është drejtuar me kërkesë Zyrës së Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës ashtu që pozita e tij si zyrtar i gjendjes civile të jete sipas katalogut të ri për vendet e punës për shërbimin civil, gjegjësisht pozita e tij nga klasa profesional 3, të klasifikohet në klasën profesional 2. Ndërsa, Njësia e Burimeve Njerëzore përmes Zyrtarit të Lartë të Personelit përmes e-mailit të datës 14.03.2025 ka njoftuar ankuesin se: *komuna ka miratuar buxhetin për vitin fiskal 2025 dhe është planifikuar për pozitat e tilla koeficienti 3.92, dhe për rrjedhojë pas miratimit të katalogut të vendeve të punës i jemi drejtuar Zyrtarit Kryesor Financiar me kërkesë për të kërkuar konfirmimin për mjete buxhetore dhe meqenëse nuk kemi marr përgjigje nuk mund të veprojmë me ndërrimin e akt emërimeve, duke e udhëzuar që mund të parashtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

Ankuesi më datë 19.03.2025 kishte parashtruar ankesë në KPMSHCK me pretendimin që pozita e tij të klasifikohet sipas Katalogut të Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ndërsa, Këshilli më Vendimin A.nr.506/2025, të datës 24.04.2025, ka aprovuar ankesën e palës ankuese dhe ka detyruar Kryetarin e Komunës dhe Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës të ndërmarrin veprimet në kuptim të klasifikimit të pozitës së ankuesit në pajtim me Rregulloren për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil. Në zbatim të vendimit të Këshillit, Komisioni i Ristrukturimit i Komunës së Klinës më datë 12.06.2025 ka nxjerr Propozimin 02Nr.112-17425/2025, me të cilin ka bërë përfundimin e procedimit administrativ të procesit të ristrukturimit për ankuesin më arsyetimin se i njëjti sipas Aktit të emërimit të datës 02.09.2024 është sistemuar në klasën profesional 3, dhe se përgatitja e tij profesionale e shkollës së mesme e pamundëson në sistemimin në klasën profesional 2.

Ankuesi serish parashtroi ankesë në KPMSHCK duke kundërshtuar Propozimin e Komisionit të Ristrukturimit të datës 12.06.2025, duke pretenduar se ky propozim është në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi që ankuesi nuk është sistemuar në klasën siç është paraparë për pozitat e Zyrtarëve të Gjendjes Civile, respektivisht në klasën profesional 2. Kërkon që ankesa të aprovohet, të obligohet Komuna e Klinës që të bëjë sistemimin në klasën profesional 2 siç parashihet sipas Katalogut të Vendeve të Punës në Shërbimin Civil si dhe kompensimin e diferencës së pagës nga profesional 3 në profesional 2 nga data 23.10.2024.

Në kuptim të themelësisë dhe bazueshmerisë së pretendimeve ankimore, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenit 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *''1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit,.. 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj'', dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstaton se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.*

Në kontekst të konstatimit si më sipër, Rregullorja (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përcakton:

- **Neni 22,** 1. *Çdo vend pune në shërbimin civil, është pjesë e një prej klasave në shërbimit civil të përcaktuara sipas kësaj Rregullore. 2. Çdo pozitë konkrete e kategorisë profesionale, klasifikohet si pjesë e një prej tri (3) klasave të kategorisë përkatëse. 3. Klasifikimi i një pozite në kategorinë e profesionale apo të specialistëve bëhet në bazë të procesit të vlerësimit dhe klasifikimit të punës në pajtim me nenet 21-26 kësaj Rregulloreje.*

- **Neni 23:** 1. *Klasifikimi i një vendi të punës të kategorisë së specialistëve dhe profesionale si pjesë e një prej klasave të parashikuara në nenin 14 dhe 15 të kësaj Rregullore, bëhet nëpërmjet analizës dhe vlerësimit të nivelit të faktorëve të klasifikimit dhe të kriteret e përgjithshme të kërkuara. 12 2. Analiza e faktorëve të klasifikimit bëhet për çdo faktor mbështetur në përshkrimin e vendit përkatës të punës. 3. Karakteristikat që paraqet pozita konkrete sipas secilit faktor, krahasohen me karakteristikat e faktorëve të klasifikimit të përcaktuar për çdo klasë në pajtim me Shtojcën Nr. 1 të kësaj Rregulloreje. 4. Pozita vlerësohet e klasifikuar në atë klasë me karakteristikat sipas faktorëve të cilës ka më shumë ngjashmëri.*

- **Neni 24:** *Vlerësimi për klasifikimin e pozitave të punës të kategorisë të specialistëve dhe kategorisë profesionale, bëhet nga Grupi i Vlerësimit, çdo herë që përgatitet një Rregullore e organizimit të brendshëm të institucionit.*

- **Neni 27:** 1. *Klasa të cilës i përket secila pozitë konkrete e kategorisë së specialistëve dhe profesionale, përcaktohet dhe miratohet njëkohësisht me Rregulloren për Organizim të Brendshëm të Institucionit. 2. Miratimi përfundimtar i klasifikimit të vendeve të punës ndjek procedurën për propozimin dhe miratimin e Rregullores së Organizimit të Brendshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.*

-Nenit 33, i cili përcakton: *Një nëpunës civil i cili aktualisht është i vendosur në një klasë të kategorisë profesionale dhe nuk posedon nivelin dhe llojin e arsimimit të përcaktuar për atë klasë, sipas kësaj Rregulloreje, vazhdon të mbaj pozitën nëse së paku tri vitet e fundit ka vlerësim pozitiv të rezultateve në punë.*

Në kuptim të bazës ligjore si më sipër dhe në ndërlidhje me pretendimet e ankuesit Kolegji thekson faktin e pakontestueshëm se sipas Katalogut të Vendeve të Punës në Shërbimin Civil pozita Zyrtar i Gjendjes Civile është përcaktuar më Kodin SHC-1118, klasa Profesional, 2 Grupi i shkencave shoqërore (Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori), ndërsa, referuar Shtojcës Nr. 1/6 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si kriteret të përgjithshme formale për klasën profesional 2 janë përcaktuar diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), diplomë e nivelit të pestë të KKK, për fushën e TIK, kështu që, nisur nga ky përcaktim ligjor rrjedhë së pretendimet ankimore të ankuesit për klasifikim të pozitës së tij në klasën profesional 2 janë të pabazuar, mbi arsyet se ankuesi ka vetëm shkollim të mesëm, respektivisht i njëjti nuk ka të përfunduara studimet themelore universitare (studime të nivelit të parë-bachelor)

Po ashtu, Kolegji për trajtim të drejtë të kësaj çështje administrative mori parasysh edhe përcaktimet ligjore sipas nenit 33 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ku parashihet se: *Një nëpunës civil i cili aktualisht është i vendosur në një klasë të kategorisë profesionale dhe nuk posedon nivelin dhe llojin e arsimimit të përcaktuar për atë klasë, sipas kësaj Rregulloreje, vazhdon të mbaj pozitën nëse së paku tri vitet e fundit ka vlerësim pozitiv të rezultateve në punë..*” dispozita këto që nuk gjejnë aplikim në rastin e ankuesit sepse përkundër që ankuesi ka ushtruar pozitën e zyrtarit të gjendjes civile më shumë se tri vite dhe ka vlerësime pozitive në tri vitet e fundit, i njëjti nuk ka arsim universitar siç kërkohet për pozitën në fjalë.

Andaj, mbi arsyet si më lartë, Kolegji vlerëson se Propozimi 02 Nr.112-17425/2025 i datës 12.06.2025, i Komisionit të Ristrukturimit të Komunës së Klinës lidhur me klasifikimin e pozitës së ankuesit është vendim i drejtë dhe i nxjerr në pajtim të plotë më të drejtën materiale. Rrjedhimisht, në kuptim të nenit 18, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 ,paragrafi 2 të Ligjit Nr.L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji refuzoj ankesën si të pabazuar duke lënë në fuqi si të ligjshëm Propozimin 02Nr.112-17425/2025, të datës 12.06.2025, të Komisionit të Ristrukturimit të Komunës së Klinës.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1174/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit A.P;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.